

VENDIM
Nr.1511, datë 29.11.2008

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES PËR THEMELIMIN E
SHKOLLËS RAJONALE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (ReSPA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes për themelimin e shkollës rajonale të administratës publike (ReSPA), të datës 12 shtator 2008, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha